dokumentit që vërteton pozitën e tij si pronar i firmës. Njoftimi i hollësishëm në lidhje me këtë gjendet në zyrat tona, por me kërkesën tuaj mund t'ju njoftojnë edhe gojarisht.

## Numrat telefonik të specialistëve tanë mjek:

Dr. Kassai Gabriella +36-20/234-2925  
Dr. Kozma Brigitta +36-20/261-3626  
Dr. Mezösi László +36-20/251-9989  
Dr. Németh Endre +36-30/218-9004  
Siklósné dr. Révész Edit +36-20/255-2122

## Numri telefonik i specialistit tonë mjek të pavarur:

Dr. Bakanek György +36-20/365-5959

## Produktet e Forever Living Products i nxjerrim në treg me rekomandimin e Shoqatës së Mjekësisë Popullore të Hungarisë.

## PËRFAQËSITË TONA

### Forever Living Products

- Qendra Mësimore: 1067 Budapest, Szondi utca 34. tel.: +36-1/332-5956, +36-20/253-3614 Menaxher projekti: Dr. Gothárd Csaba Ndryshon orari i hapjes së magazinës së rrugës Szondi: H-P: 10:00-21:00
- Drejtoria e Tregëtisë e Budapestit: 1183 Budapest, Nefelejcs u. 9-11. tel.: +36-1/291-8995, +36-20/465-6280 Drejtori i rajonit: Földi Attila
- Drejtoria Rajonale e Debrecenit: 4025 Debrecen, Erzsébet u. 48. tel.: +36-52/349-657, +36-20/914-2945 Drejtori i rajonit: Pósa Kálmán.
- Drejtoria Rajonale e Szegedit: 6721 Szeged, Tisza Lajos krt. 25. tel.: +36-62/425-505, +36-20/251-1712 Drejtori i rajonit: Radóczki Tibor
- Drejtoria Rajonale e Szekesfehervarit: 8000 Szekesfehervár, Sóstói út 3. tel.: +36-22-333-167, +36-20/467-8603 Drejtori i rajonit: Kiss Tibor

### Forever Resorts

- Hoteli Kështjella e Szirakit 3044 Szirák, Petőfi u. 26. tel: +36-32-485-300, fax: +36-32-485-285. Drejtoresha e hotelit: Király Katalin Faqja e internetit: [www.kastelyszirak.info](http://www.kastelyszirak.info)




# Shkëlqim i natyrshëm

**Aneta Dimitrovski përfaqësoi Serbinë dhe rajonin e Europës juglindore në konkursin e bukurisë Miss FLP Europa në Londër. Me rreshtat e mëposhtme i përshëndet të gjithë.**

**P**roduktet e FLP-s më pëlqyen tetë vjet më parë kur me ndihmën e firmës morra përgjigje pozitive në një situatë delikate të jetës sime. Falenderimin tim ia shpreha duke hyrë në familjen e madhe të kompanisë ku fillova një punë aktive dhe të zellshme. Prej meje rrezantonte Aloe Vera dhe kënaqësia e vërtetë e ardhur nga efektet e mira të shkallës së gjerë të produkteve. E përhapa shpejt këtë „infeksion” në mjedisin tim, dhe falë kësaj u bëra menaxhere. Për këtë më ndihmuan shumë faktet, rinia dhe forca ime tërheqëse e vetëlindur. M’u nevojit kohë e gjatë derisa i provova gjithë produktet e Sonya® Colour Collection, sepse produktet e shumta ofrojnë një numër të madh mundësish kombinimi. Kur zbulova magjinë e gjithë koleksionit, e ndava edhe me të tjerë entuziazmin tim. Me produktet e Sonya® Colour Collection vura re se me përdorimin e tyre shkëlqej me të vërtetë. Pas kësaj nuk kisha dyshim që zotërojmë pudra, bojra sysh dhe skuqës tepër të veçantë, të cilët të sigurojnë bukuri, freski dhe diçka të cilën e dëshirojnë të gjitha femrat: shkëlqim të natyrshëm – pa shumë makijazh. Këto produkte kozmetike i përdor vetë, dhe me këtë i reklamoj ato më mirë. Me ato nis çdo ditë. Ëndërroj që t’i tregoj edhe në Shtetet e Bashkuara tiparet e femrës që vjen nga rajoni ynë – ashtu siç përfaqësoj unë FLP Serbinë.

Puna e kryer në FLP për mua është një vendim jete. Në këtë familje të madhe gjeta qëllimin e jetës sime dhe shumë miq të vërtetë.





**Dy lojtarë të mëdhenj,  
mund të themi dy tipa  
fituesish u takuan atë ditë  
kur u prezantuan me njëri  
tjetrin Tamas Biro dhe  
Diana (sot gjithashtu Biro).  
E konsiderojnë si një nga  
shitëset më të suksesshme  
dhe zonja e produkteve  
Sonya: vetëm fituan  
me faktin që guxuan të  
bashkojnë forcat e tyre. Por  
ky nuk ishte hapi i vetëm  
i guximshëm në jetën e tyre.**

# MOS ZGJIDH ASNJËHERË RRUGËN MË TË LEHTË!

ÇIFTI BASHËSHORTOR BIRO

## E dimë që kjo histori bën fjalë rreth „përjetësisë”. Për ju kur filloi?

**Diana:** Tomi është prej trembëdhjetë vitesh famurtar i kësaj historie, kurse unë e fillova para katër vitesh i pavarur nga ai. Na prezantuan në një ditë suksesti dhe aty u vendos fati ynë. Në çdo aspekt. Gjithçka që shikon këtu ia dimë për nder FLP-s, pasi na finansirozon gjithë jetën përveç faktit që shfrytëzojmë edhe programet e ndryshme motivuese.

**Tamas:** Me programet e reja motivuese mund të arrihet për gjysmën e kohës aty ku ne arritëm atëherë. Megjithatë edhe ne patëm rezultate të bukura në 97-ën. Më kujtohet kur e fillova dhe në muajin e parë solla në shtëpi 21 mijë forinta, në muajin e dytë 113, në të tretin 214, pastaj 352, 508, 1.0269... por vetëm sepse e pashë që dikush e kishte bërë këtë para meje, dhe kjo është e rëndësishme.

## Nevojiten shembuj?

**Tamas:** Ishte një atlet i njohur i cili nuk e dinte se një milje nuk mund të bëhej për tre minuta ashtu siç e vrapoi ai. Atë vit e bënë edhe gjashtë të tjerë. Të gjithë kanë nevojë për një shembull, dhe ky biznes mund të ndiqet. Shkaku i asaj që bëmë vjet në nëntor, që praktikisht i kaluam të gjithë, ishte një konsultim me sponsorin tonë. Kjo duhej që të nxirrnim një rezultat të tillë nga vetja. Të pëlqen të ngasësh biçikletë?

## Me raste.

**Tamas:** Ka ndodhur ndonjëherë që të ka dalë gjuha jashtë dhe ke thënë se nuk duroje dot më, do të binte të fikët? Po të dilte atëherë një qen i etur për gjak, çfarë do të bëje?

**Ndoshta do t'i jepja mëtej biçikletës.**

**Tamas:** Jo ndoshta, por e sigurt që do t'i japësh më shpejt se kurrë, pasi ke një motivim. Të shtyn instinkti i jetës. Unë përshembull në fillim kisha shumë miliona borxh dhe isha me të vërtetë në hall. U takova me këtë biznes dhe pash tek ai mundësinë e jashtëzakonshme për një njeri të zakonshëm. Natyrisht duhet të zhvillojmë shumë personalitetin. Nëse njeriu lexon dhe mëson shumë, bëhet.

## Po aftësitë e vetëindura?

**Tamas:** Ky biznes është 95 përqind çështje qëndrimi dhe vetëm 5 përqind çështje teknike. Të tjerat t'i harrojmë.


## Për cilin rezultat jeni më krenar?

**Tamas:** Gjithmonë për të fundit.

**Diana:** Por mund të themi se këtë biznes asnjëri nuk e ka bërë dy herë me të njëjtat përmasa.

**Tamas:** Po, kur e bëra për harë të parë ishte biznesi i gjashtë më i madh në Hungari. Pastaj u ndava dhe lashë gjithçka prapa. Pastaj pyeta që a mund të hyj përsëri. Drejtori gjeneral Dr. Sandor Milesz e dinte që jam person problematik, por prapë e fillova dhe besimi i tij më frymëzoi. Ky biznes nuk mund të bëhet pa faktorin njeri, pasi sado e shkëlqyer të jetë ajo që ofrojmë, s'kam parë ndonjëherë që një produkt t'i shes një produkti një produkt tjetër.

**Dia, gjendja jote në dukje ishte më e lehtë, pasi hyre në një biznes të**



**ndërtuar. Por kjo mund të ketë  
qenë edhe një sfidë e madhe.**

**Diana:** Sigurisht që ishte e tillë, por u bëra shembull për shumë njerëz, kështu që nuk mund të hiqja dorë, ishte një zhvillim personaliteti interesant për mua. Mendova se duhet ta meritoj të jem gruaja e Tamas-it dhe të ndihmoj rretin e tij. E dija që atij nuk i duhej një femër e nënshtruar, por ka nevojë për një shoqe e cila i qëndron pranë në të mira e të këqija. Dhe unë ju përgjigja kësaj detyre dhe më në fund u vertetua që ishte vendimi më i mirë i jetës sime.

**Hoqe dorë plotësisht nga puna jote?**

**Diana:** Po, por media më pëlqen akoma shumë, për dhjetë vjet me radhë më edukoi për këmbëngulje dhe respekt. Kurse punën në skuadër e mësova nga e kaluara ime sportive dhe FLP-ja.

**Tamas, kur nuk dëgjon zemrën,  
atëherë cilit i jep mundësi?**

**Tamas:** Zgjedh shumë në biznes, e

shikoj mirë se cili është ai që duhet këtu. Kur u bëra menaxher skuadra ime përbëhej nga tridhjetë e gjashtë njerëz. Ka nga ata që janë me qindra dhe nuk i arrijnë dot rezultatet tona.

**Tani sa njerëz ke në skuadër?**

**Tamas:** Nuk e di saktësisht, për mua ky nuk është tregues. Dikujt i pëlqen të flasë me shifra të mëdha. Unë kam disa njerëz me të cilët më pëlqen të jem kur nuk bëhet fjalë rreth Forever-it, dhe kjo është më e rëndësishmja.

**Me siguri të pyesin shumë njerëz  
rreth marifeteve dhe sekreteve  
të tua...**

**Tamas:** Kështu është, por ose e ndjen vetë se si duhen zgjedhur, mbështetur dhe drejtuar njerëzit, ose është e kotë ta shpjegoj. Mund të të mësoj disa fjali kyçe, por kjo nuk të ndihmon. Unë mendoj në mënyrë vizuale. Imagjinoja edhe për Dia-n, dhe ia ku e kam këtu.





### **Dhe nëse jeta nuk ta sjell atë që imagjinon, atëherë e ndryshon atë ashtu siç e do?**

**Tamas:** Jo, e përvetësoj atë që dëshiroj. Nuk ndryshoj sepse atëherë dështova. Por për këtë duhet të dish t'i vlerësosh gjërat. Kur në Las Vegas shikonim lojën e dritave të shatërvanit përpara Ballagios... ku të gjithëve u derdhen lot në sy... dikush pyeti se sa paguajnë këtu për dritat. Është vështirë me njerëzit. Shpeshherë mendon se edhe tjetri mendon njëlloj si ty, por jo.

### **Cili është qëllimi kryesor?**

**Diana:** Që rrjeti vendas të mos qëndroj në shkallën e tretë të podiumit, por në të dytën ose në të parën mes 143 shteteve. Megjithatë aty qëndrojmë në Europë dhe në botë në raport me popullsinë. Hungarezët janë gjeni. Vetëm nuk e besojnë këtë rreth vetvetes. Mua në dy javët e para më refuzuan pesëdhjetë e katër njerëz. Por nuk më intersonte. Ideja është që tek kush ke besim, cili është sponsori që të merr për dore. Nëse nuk e ndryshon të zakonshmen, s'ka për t'u shfaqur e mundshmja.

**Tamas:** Njeriu i zakonshëm nëse shikon dy tabela në një kryqëzim: rrugë e lehtë, rrugë e vështirë, zgjedh rrugën e lehtë. Kurse unë gjithmonë më të vështirën. Ai që do të zhvillohet i nevojitet e panjohura plot me sfida.

### **Ti ku duhet të ndryshoje?**

**Tamas:** Isha skeptik, nëse nuk e shikoja shembullin nga të tjerët, nuk e bëja. Por në Poreç kisha nja dy biseda serioze me Attila Gidofalvi-n. Atë ditë hoqa dorë nga cigarja, nuk pi më as një pikë alkool, kafe dhe nuk konsumoj më mish të kuq. Pësova një goditje në kokë, vendosa të bëhem më i mirë. Dhe nga muaji në muaj e ndjemë rritjen në biznes. Ashtu si bëhemi, të tillë njerëz tërheqim pas vetes.

### **Të interesojnë të mirat që mund të blihen me para?**

**Tamas:** Më pëlqejnë makinat, por pas disa muajsh u zbehet magjia. Kurse mbresat që marrim gjatë udhëtimeve nuk zbehen dhe na mbajnë në lëvizje.

### **Pavarësi, dashuri: Dia, ti po thua që të dyja ia di për nder FLP-s. Por këtu është edhe diçka tjetër, skena...**

**Diana:** Kam kënduar për pesë vjet me radhë në korin e fëmijëve të radios hungareze, isha një mes njëqind e njëzet njerëzve. Kurse këtu, në Super Rally arrita që bashkë me shoqen time Klari Hertelendy të shfaqem përpara mijëra njerëzve në Los Angeles, ndërkohë që dyqind hungarez më duartrokisnin duke valëvitur flamurin. Ishte një ndjenjë e paharrueshme.

### **Tek ju gjithçka është e jashtëzakonshme. Përshembull shkuat në muaj mjalti para dasmës.**

**Diana:** Ishim një muaj në ishujt Hawaii, vend përrallor, shumë i bukur. U uroj të gjithëve që të paktën njëherë në jetë të shkojnë në një vend të tillë, ku dëshirojnë shumë.

### **Nga udhëtimi edhe mëson?**

**Tamas:** Sigurisht. Respekt. Kur ishim për herë të parë në Shtetet e Bashkuara në vitin 1999, unë si bravandreqës dhe punëtor ndërtime, u magjepsa nga muri prej xhami i Hiltonit, dhe pyeta vetveten që: çfarë kërkoj unë këtu? Nuk më besohej që ajo që bëja, të cilën nuk e konsideroj si punë, më shpërbleu duke më çuar në majën e botës...

### **Çfarë do e quaje, nëse jo punë?**

**Tamas:** Kjo është një mënyrë jetese. Nëse të mësoj atë që unë di, dhe ti i shton atë që di vetë, mund të bëhesh më shumë se unë. Dhe pikërisht ky është qëllimi, me këtë vetëm përfitojmë. Ajo që kemi arritur është e bukur, por jemi akoma larg fundit, dhe kjo nuk merr fund atëherë kur vjen fundi ynë. Biznesi i madh mund të bëhet prej shumë gjërash, por të krijosh një pikëpamje që të mbijeton ty: kjo është gjëja më e madhe që ekziston.





## *E dashur Shqiponjë e re!*

**T**ë përhëndes me respekt dhe dashuri Ty, që tani hyre në një firmë të vërtetë botërore. Të uroj nga zemra për vendimin tënd! Me siguri pate shkak të mirë për të. E di që mund të zgjidhje edhe nga produktet e prodhuesve të tjerë dhe mund të nisje biznes në fushë tjetër dhe me firma të tjera MLM.

Por ti prapë na zgjodhe ne. Kjo mund të ketë shkaqe të shumta – ti me siguri e di të vërtetën, si dhe që për ty ky shkak është më i rëndësishmi në botë, sepse është vetëm i yti. Kujdesu për të, ruaj përse-të e tua, ndize ndjenjën që të solli në vendin më të mirë. Qëndroi besnik dhe mos lejo asnjëri që të thojë fjalë të këqija. Ka nga ata që vendosin kështu për shkak të produkteve që s'kanë ndryshuar prej 32 vitesh, prandaj janë të sigurt, me cilësi të lartë, përfaqësojnë vlera të veçanta në tregun botëror në fushën e mënyrës së shëndetshme të jetesës dhe ruajtjes së bukurisë, janë të pastra dhe zotërojnë certifikata të shumta cilësie.

Ka nga ata që e kanë ndjekur dhe e ndjekin me vëmendje edhe sot shfaqjen dhe zhdukjen e firmave të ndryshme MLM në Hungari. Dhe këta shikojnë që Forever Hungari bashkë me rajonat sllavo-jugore janë e vetmja firmë e cila rritet vazhdimisht prej 13 vitesh, nuk ka mbyllur asnjë qendër të saj në asnjë shtet, nuk bëri shkurtime në punë pavarësisht nga fakti që çfarë dëgjojmë dhe shikojmë në media e cila flet rreth një farë krize, por ne për shkak të plotësisht të kërkesave gjithmonë në rritje nuk kishim as kohë e as mundësi të merreshim me këtë.

Ne qëndruam jashtë kësaj... Ne që jemi afërsisht 800 mijë vetë në rajon, kemi detyra të mëdha: të ndihmojmë 800 mijë njerëz të tjerë që na presin, të cilët kanë nevojë për produktet tona dhe dëshirojnë të jetojnë me shëndet të mirë, të lumtur, në pasuri dhe me sukses me familjet e tyre.

Ka nga ata që u bashkuan me ne sepse kanë punuar më parë me firma të tjera MLM, dhe nuk kanë marrë atë që prisnin. Në shumë firma u kanë folur vetëm rreth të kaluarës së sukseshme pa produkte me cilësinë e duhur apo mësim dhe trainim falas, profesionist, me nivel botëror. Në mënyrë të papërgjegjshme dhe të pabazuar, duke mos i marrë parasysh rregullat e zanatit, u premtuan pasurim të shpejtë, madje edhe sot dëgjojmë shpesh shprehjet joshëse „ejani tek ne mes të parëve, sepse tani po nisemi”. Ka nga ata që bashkohen sepse e dinë që Forever gjatë 32 viteve s'është vonuar asnjëherë si në aspektin e pagimit të transportuesve dhe shpërblimeve prej disa milionash të rrejtëndertuesve, edhe në atë të derdhjeve bankare të të ardhurave të të drejtave të autorit në bazë të kontratave tregëtare.

Ka nga ata që janë regjistruar tek ne sepse janë bindur që mund të nisin biznes personal pa investimin material, njohuritë ekonomike, rrezikun, njohurinë e tregut dhe konkurrencën që nevojitet në tregëtitë e zakonshme.

Ka nga ata që i motivoi plani ynë marketing i veçantë që e tregon veten vazhdimisht prej 32 vitesh, nuk ka ndryshuar, siguron një të ardhme të planifikueshme, të llogaritshme dhe që funksionon në mënyrë stabile në aspektin ekonomik, social dhe kulturor kudo në botë, si dhe sistemi ynë i motivimit që siguron përparësi, udhëtime të shumta dhe të ardhura shtesë (programi motivues i makinës, Holiday Rally, Rally European, Rally Amerikan, Ndarja e Profitit, Rally Botëror).

Ka nga ata që u intereson sistemi ynë NDP, sepse edhe si fillestar „i vogël” me ndihmën e sponsorit të tij për 1-2 muaj mund të fut në xhep pagesën mesatare të një hungarezi. Nëse njëherë për njëherë nuk dëshiron më tepër, edhe ky është vendimi i Tij: s'do të jetë më kurrë i papunë.

Ka nga ata që u bënë anëtarë të skuadrës Forever sepse miqtë dhe të njohurit e tij e pëlqejnë shumë këtë atmosferë të shkëlqyer dhe argëtuese, edhe ata dëshirojnë të udhëtojnë me ta me shpenzimet e firmës dy herë në vit për pushime verore me pesë yje „all inclusive” në Kroaci, të shikojnë në vendet më të bukura të Europës, dhe në çdo muaj gusht të pushojnë në Amerikë dhe të dërgojnë kartolina me Southfork Ranch-in e njohur nga Dallas apo Las Vegas.

S'ka rëndësi që kujt apo çfarë ia di për nder jetën tënde të re të Forever-it. Mos lejo asnjëri që të thotë fjalë të këqija dhe të bind të heqësh dorë nga vendimi yt. Mos i beso askujt, largohu nga vjedhësit e ëndrrave, në mënyrë që vetëm Ti ta vendosësh që çfarë dhe përse e dëshiron. Beso tek vetvetja dhe tek më të mirët. Je me ne për shkak të dëshirave dhe piksynimeve të tua, duaji shumë ata... këshilltarët e tu.

**Tibor Radoczki**  
DREJTOR RAJONAL  
SOARING MENAXHER





# PHŌNIX

BUDAPEST KFT.

ZYRË PËR SHITJE BILETASH

PRENOTIM I THJESHTË  
BILETASH AVIONI PËR  
NË ÇDO VEND  
TË BOTËS



**ZSUZSANNA GERŐ**

Prenotime në grup  
rally

**Kontaktim:**

1183 Budapest, Nefelejcs u 9–11.  
Tel: +36 1 269 5370/158  
Mobil: +36 20 593 8205  
e-mail: rally@flpseeu.hu



**GABRIELLA PITTMANN**

Prenotime personale

**Kontaktim:**

1067 Budapest, Szondi u. 34.  
Tel: +36 1 373 0025  
Mobil: +36 20 575 5553  
e-mail: repjegy@flpseeu.hu

[WWW.PHONIXREPJEGY.INFO](http://WWW.PHONIXREPJEGY.INFO)

## VËREJTJE PËR GJITHË DISTRIBUTORËT!

Punonjës të dashur!

Ju lutemi që në interes të përcjelljes më të thjeshtë e më të shpejtë të informacioneve të mbushni kuponin e mposhtëm dhe të na i dërgoni në adresën: Forever Living Products Magyarország Kft., 1067 Budapest, Szondi u. 34. Kuponin i prerë mund të dorëzohet edhe personalisht në secilën prej magazinave tona. Ju urojmë mëtej punë rezultative dhe të suksesshme!



**Kodi:**

**Emri:**

**Numri i telefonit:**

**Adresa e-mail:**

# NJOFTIMET E ZYRAVE



## SERBIA

**Zyra e Beogradit:** 11000 Beograd, Kumodraska 162, tel.: +381 11 3970 127. Orari i hapjes: të hënën, të martën dhe të enjten 12.00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9.00-16.30.

**Zyra e Nishit:** 18000 Niš, Učitelj Tasina 13/1., tel.: +381 18 514 130, +381 18 514 131.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 11.00-19.00, në ditët e tjera të punës 9.00-17.00.

**Zyra e Horgoshit:** 24410 Horgoš, Bartok Béla 80. tel.: +381 24 792 195. Orari i hapjes në ditët e punës: 8.00 - 16.00. Drejtori i rajonit: Branislav Rajic.

**Drejtori i rajonit:** Branislav Rajic.

### Forever Living Products Beograd na ofron shërbimet e mëposhtme:

bërje porosish në telefon - Telecenter. Numri i telefonit: 011/309 63 82. Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12: 00-19.30, të mërkurën dhe të premten 9:00-16.30. Në rastin e porositjes në telefon malli shkon tek adresa që gjendet në numrin e kodit dhe paguhet kur merret në dorë.

– Pagesa e produkteve bëhet pasi ato merren në dorë.

Vlera e transportit është 600 dinar dhe paguhet nga porositësi.

– Shpenzimet e postës duhen paguar në bazë të kursit të parasë në Serbi në ditën që ndodh marrja e mallit, dhe ato merren përsipër nga FLP-ja e Beogradit vetëm në rastin kur vlera e porositë së bërë është më e madhe se 1 pikë.

– Nuk mund të bëhet regjistrim nëpërmjet telefonit.

– Porositë telefonike merren në shqyrtim deri në datën 25 të muajit, pas kësaj date mund të porosisni vetëm personalisht në zyrën tonë.

– Edhe në zyrën e Horgosit dhe Nisit mund të blihen materiale reklamash, fletat e regjistrimit dhe formularët për ndryshimin e të dhënave.

### Numrat i telefonit të specialistëve mjek:

**Dr. Biserka Lazarević dhe dr. Predrag Lazarević:**

+381 23 543 318

Të martën në orën 13.00-16.00 dhe të premten në orën 14.00-16.00 presin thirrjet tuaja për konsultim.

**Dr. Božidar Kaurinović:**

+381 21 636 9575

Të mërkurën dhe të enjten në orën 12-14 pret ethirrjet tuaja për konsultim.



## MALI I ZI

**Zyra e Podgoricës:** 81000 Podgorica, Serdara Jola Piletića 20. tel. +382 20 245 412, tel./fax: +382 20 245 402.

Orari i punës: të hënën: 12:00 – 20:00. Në ditët e tjera të punës: 9:00 – 17:00. E shtuna e fundit e çdo muaji është ditë pune. Orari i punës: 9:00 – 14:00.

### Drejtori i rajonit: Aleksandar Dakić

– Porosi produktesh mund të bëni në numrat telefonik të mëposhtëm: +382 20 245 412; +382 20 245 402.

Pagesa bëhet kur merret malli. Nëse vlera e produktit të porositur e kalon 1 pikë, shpenzimet e transportit i merr përsipër FLP-ja.

### Numri i telefonit i specialistes mjek:

**Dr. Laban Nevenka:** +382 69 327 127



## SLLOVENIA

**Zyra e Ljubljanes:** 1236 Trzin-Ljubljana, Borovec 3., tel.: +386 1 562 3640.

Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten 12.00-20.00, të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00-17.00.

**Adresa e magazinës së Lendavait:** 9220 Lendava, Kolodvorska 14.. tel.: +386 2 575 12 70, Fax: +386 2 575 12 71, e-mail: forever.living@siol.net. Orari i hapjes: të hënën 12.00-20.00, të martën dhe të premten 09.00-17.00.

### Drejtori i rajonit: Kepe Andrej

Numri i Telecenterit në rastin e porosive telefonike është: +386 1 563 7501. Në rastin e porosive telefonike, mallin e dërgojmë në adresën që i përket kodit. Distributorët që duan të porosisin mall në emër të një distributori tjetër, duhet të kenë autorizim nga distributori në emrin e të cilit duan të bëjnë porosinë. Formularët e autorizimit mund të sigurohen në zyrë. Malli i porositur në telefon transportohet për dy ditë pune!

### Numri i telefonit të specialistëve mjek:

**Dr. Arbeiter Miran:** +386 4142 0788



# JUGLINDORE



## KROACIA

**Zyra e Zagrebit:** 10000 Zagreb, Trakošćanska 16.  
tel: +385 1 3909 770; Fax: +385 1 3909 771  
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 09.00–20.00;  
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00.

**Zyra e Rijekës:** 51000 Rijeka Strossmayerova 3/A.  
Orari i hapjes: të hënën dhe të enjten: 12.00–20.00;  
të martën, të mërkurën dhe të premten 09.00–17.00  
tel: +385 51 372 361, +mobil: +385-91/455-1905

**Drejtori i rajonit:** Dr. Laszlo Molnar

– Porosi telefonike: +385 1 39 09 773,  
+385 1 39 09 775.

Në rastin e porosive me vlerë më të madhe se 1 pikë krediti,  
çmimi i transportit paguhet nga FLP Kroacia.

– Leksionet në lidhje me njohjen e produkteve: të hënën, të  
martën dhe të mërkurën 17.00

– Nëse vlera e blerjes është më e madhe se 1500 kuna ekziston  
mundësia e pagesës në dy-tre pjesë me kartën Diners Club.

### **Numri i telefonit të specialistëve mjek:**

Dr. Ljuba Rauški Naglic,  
mobil: 091 51 76 510

Në ditët teke në orarin 16.00–20.00.



## BOSNIA-HERCEGOVINA

**Zyra e Bijelinës:** 76300 Bijeljina, Trg D. Mihajlovića 3.,  
tel: +387 55 211-784, +387 55 212-605, fax: +387 55 221 780.  
Orari i hapjes në ditët e punës: 9.00-17.00.

**Drejtori i rajonit:** Dr. Slavko Paleksić

**Zyra e Sarajevës:** 71000 Sarajevo, Akita Šeremeta do br. 10., tel.:  
+387 33 760 650, +387 33 470 682, fax: +387 33 760 651. Orari i  
hapjes: të hënën, të enjten, të premten: 09.00–16.30, të martën, të  
mërkurën: 12.00-20.00. Në çdo të shtunë të fundit të muajit (ditë  
pune) organizojmë një Ditë Sukses mini në zyrën e FLP-s.

**Drejtoresha e zyrës:** Enra Hadžović

– Në zyrat e Bosnias porositë telefonike mund të bëhen në  
numrat e mëposhtëm (regjistrimi i shpërndarësve të rinj nuk  
mund të bëhet nëpërmjet telefonit): +387 55 211 784,  
Bijelinë dhe +387-33-760-650 Sarajevë.

### **Numri i telefonit të specialistëve mjek:**

Dr. Nišić Esmā +387 62 367-545, e cila gjatë ditëve të  
punës punon në orarin 18:00 – 21:00.

– Këshilltarja-specialistja jonë mjekje çdo të mërkurë mban  
konsultime në zyrën e Sarajevës në orarin 17:00 – 19:30.

– Në rastin e porosisë telefonike pagesa bëhet kur merret malli.  
Nëse vlera e porosisë nuk është më e madhe se 1 pikë krediti,  
atëherë shpenzimet e transportit paguhet nga distributori.



## SHQIPËRIA

**Zyra e Tiranës:** Tiranë, Reshit Collaku 36. tel/fax: +355  
42230 535.

**Drejtori rajonal:** Attila Borbáth

**Drejtori i zyrës:** Xhelo Kiçaj, tel/fax: +355 694 066 811.  
Kontaktim: në ditët e punës 9-13, 16-20,  
e-mail: fpalbania@abcom.al



## KOSOVA

Pristinë Rr. Uçk br. 94, tel.: +381 38 240 781,  
+377 44 503 911.





# STARTO MIRË NË FLP!

**H**istoria jonë filloi vite më parë. Të dy jetonim jetën e njerëzve të zakonshëm. Unë si kryeeducatore drejtoja Kopshtin e Qendrës së qytetit Baja, kurse burri im mernte në provim shoferët. Punonim 8-10 orë në ditë, kishim shumë stres dhe shumë pak kohë për njëri tjetrin dhe edukimin e vajzës sonë. Pastaj mua m'u shfaqën probleme shëndetësore dhe nga sponsorja ime e ardhshme, **Keszei Janosne Kati** morra dhuratë një pije në shishe të verdhë. Kishte një shije të egër dhe ekzotike,

por vendosa ta pij për qejf të Katit. Kur mbaroi shishja isha e bindur se mua kjo më nevojitet, prandaj shkova tek **Rozsahegyine Marika dhe Zsolti** që të më thonin se përse e ndiej më mirë veten? Ata më ndihmuan dhe prandaj do ua di për nder gjatë gjithë jetës. Më ndihmuan edhe në mposhtjen e rezistencës së burrit tim i cili sot është një nga besimtarët më entuziast të FLP-s. Përvojat e mira dhe shembulli i treguar nga linja jonë e sipërme na nisi në rrugën drejt ndërtimit të rrjetit. Sot Forever-i është puna kryesore për të dy ne.

Jetojmë një jetë të pavarur dhe të lumtur. **Rozsahegyine Marika dhe Zsolti, Sanyi dhe Edina Toth, Miki Berkics** na tregojnë rrugën dhe ne jemi krenar që jemi anëtarë të skuadrës së tyre. Kemi folur me shumë njerëz ndër të cilët ka nga ata që erdhën me ne, dhe ka nga ata që na refuzuan. Këtë kishte raste që e përballonim me vështirësi, por sot punojmë së bashku me shumë njerëz me vlerë. Jemi shumë krenar për ta dhe jemi të sigurt që do të bëhen të suksesshëm dhe do t'i arrijnë piksynimet e tyre.

## ÇFARË TË NEVOJITET QË TË BËHESH I SUKSESSHËM?

- Një vendim të cilin e mban. Vendimi është i Yti, mos hiq dorë që në vështirësitë e para! Vështirësi ka patur, ka dhe do të ketë!
- Je treguar këmbëngulës për shumë gjëra në jetën tënde! Tregohu edhe tani në interes të vetvetes dhe familjes tënde.
- Mos bë kometë në qiellin e FLP-s!
- Mbaj shënim pikësnyimet e tua! Pikësnyimet nga të cilat të rreh zemra dhe të cilat të japin forcë të kapërcesh refuzimet.
- Shkruaji të gjithë në listën tënde të emrave, sepse nuk mund ta dish se cili do të jetë ai që vjen me Ty në këtë rrugë.
- Guxo t' u flasësh njerëzve, sepse u jep atyre dhuratën më të bukur: një mundësi jete më të shëndetshme, më të lumur dhe më të pasur.
- Merre seriozisht FLP-n në mënyrë që edhe FLP-ja të të marrë seriozisht Ty!
- Merre seriozisht këtë punë, sikur të varet jeta nga ajo, sepse kështu është!
- Mos e ndërliko shumë ndërtimin e biznesit, puno "pastër dhe thjeshtë"!
- Zbato rregullat e biznesit dhe përpiqu ta zbatosh me përpikmëri planin marketing!
- Rruga nuk do të jetë gjithmonë e lehtë, do të ketë edhe pengesa, por në fund të tunelit të pret Drita!
- Ndrysho, zhvillohu! Lexo libra, dëgjo CD, merr pjesë në aktivitete! Aty do të marrësh përgjigjen që të çon përpara.

Si përfundim dëshiroj të falenderoj skuadrën tonë që na ndjekin dhe kanë besim tek ne. Jemi shumë krenar për Ju! Prej jush dalin gjithmonë e më shumë drejtues: **Aniko Zsikone, Csilla Puskasne, Edit Molnarne, Gizike P. Szabo, çifti Csikos, Evi Mikula, Csaba Balla, Zoli Petak;** dhe ata që tani fillojnë të fluturojnë: **Angela Lakatos, Adrienn Gelanyine, Evi Miokovics, Ica Hideg, familja Meszaros, Klari Ofenbeher, Istvan dhe Magdi Csami, Judit Csabi, Monika Berecz, Gabor Romsics, Annamari** dhe shumë të tjerë.

Tani dëshiroj t' u them një fjali atyre që janë duke pritur. Ejani përsëri mes nesh, ju presim me kënaqësi! E kenë vendin në Majë! Viti 2010 të jetë viti i suksesit për secilin prej nesh!

I falenderojmë të gjithë ata që kontribuan sikur edhe me një element të vetëm në ndërtimin e personalitetit tonë.

U urojmë të gjithëve ndërtim biznesi me rezultat!

**Edit Racz dhe Tibor Holczer  
menaxherë**



# Të pushojmë dy herë në verë - falas!



Ekzistojnë dy periudha kualifikimi. Të dyja kanë nivel 1 dhe 2. Niveli i parë do të thotë që në krahasim me pozicionin aktual ngjitesh një nivel më lartë (por të paktën në nivelin e Supervizorit) në planin marketing, dhe deri në fund të periudhës së kualifikimit në çdo muaj ke një aktivitet prej 4 pikësh. Është e vërtetë për të dyja periudhat e kualifikimit: niveli i dytë do të thotë që ngrihesh jo vetëm në nivel, por krahas ruajtjes së aktivitetit tënd (4 pikë) në të paktën dy muaj të periudhës së mbetur mbledh aq pikë sa niveli që u ngrite gjatë periudhës së kualifikimit. Përshembull nëse në mars bëhesh Supervizor, atëherë në prill dhe në maj numri i përgjithshëm pikëve të tua duhet të jetë të paktën 25 – ose nëse në qershor bëhesh me 75 pikë, atëherë edhe numri i përgjithshëm i pikëve të korrikut dhe gushtit duhet të jetë 75.

**Niveli i parë :** Forever anëtarëve të vjetër që dëshirojnë të ngrihen në nivel deri më 31 maj, por kynë hyrë në FLP para 1 shkurtit, në periudhën e kualifikimit që fillon në janar u kërkon aktivitet vetëm nga 1 marsi! Në periudhën e dytë të kualifikimit (nga 1 qershori) rregullat e aktivitetit janë: në rastin e atyre që hyjnë para 1 qershorit kërkohen 4 pikë që nga 1 qershori, kurse për ata që hyjnë pas 1 qershorit që nga muaji i ardhshëm i plotë është i detyrueshëm aktiviteti prej 4 pikësh pavarësisht nga niveli i tyre aktual i biznesit. (Edhe As. Supervizori duhet të bëjë 4 pikë që nga muaji i parë i plotë, edhe nëse nuk kualifikohen në atë muaj si Supervizor.)

Detajet:

## **I. HOLIDAY RALLY – KAPËRCE NJË NIVEL!**

**Periudha e kualifikimit:** nga 1 janar 2010 deri më 31 maj 2010.

**Kush mund të kualifikohet?** Çdo distributor i ri dhe i vjetër, i cili në planin Marketing ngjitet në një nivel më të lartë se sa niveli aktual (nga niveli i Distributorit mund të kualifikohesh vetëm me arritjen e nivelit të Supervizorit).

## **Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!**

### **Cilat janë kushtet e kualifikimit të këtij programi motivues?**

Kapërce një nivel! Gjatë periudhës së kualifikimit tregohu aktiv (blerje me vlerë 4 cc personale, nga të cilat të paktën 1 cc bëhet me kodin personal) që nga muaji i parë i plotë, pra nëse hyn në 15 shkurt 2010, atëherë që nga 1 marsi. Ngjitu një nivel më lart se sa niveli aktual në planin Marketing (ata që ndodhen në nivelin e Distributorit të arrijnë nivelin e Supervizorit). Ky është niveli 1 i Holiday Rally-t.

Pas kualifikimit në nivel më të lartë, deri në fund të periudhës së kualifikimit të Rally-t, në dy muajt që vijjnë më pas mund të arrijnë edhe nivelin 2, pra nëse nga niveli i Distributorit ose Asistent Supervizorit në mars arrin nivelin e Supervizorit, krahas ruajtjes së aktivitetit tënd qarkullimi i marsit dhe i prillit, si dhe i prillit dhe i muajit së bashku duhet të jetë 25 cc! Nëse nisesh nga niveli i Supervizorit dhe në mars arrin nivelin e Asistent Menaxherit, krahas ruajtjes së aktivitetit



**FOREVER JEP PËRSËRI MËTEPËR! PARIMI QË SHËRBEËN SI MOTOJA E VITIT 2010, NDRYSHIM (MUDANÇA) E ARRITI NË MËNYRË TË DENJË EDHE HOLIDAY RALLY-N SHUMË TË SUKSESSHËM. FALË PRESIDENT CLUB DHE DR. SANDOR MILESZ TANI FOREVER NA ÇOJNË DY HERË NË DETIN ADRIATIK, NË POREÇ, PËR TË MËSUAR, PUSHUAR DHE ARGËTUAR. TË SHIKOJMË PAK SE ÇFARË PUNE DUHET BËRË PËR TË ARRITUR KËTË ARGËTIM TË SHKËLQYER ME PESË YJE QË BËN FJALË VETËM PËR NE.**



tënd qarkullimi i marsit dhe i prillit, si dhe i prillit dhe i muajit së bashku duhet të jetë përsëri 75 cc, dhe kështu mëtej. Nëse e arrin këtë, atëherë kualifikohesh në nivelin 2 të Holiday Rally-t.

Nëse hyn në muajin e fundit të periudhës së kualifikimit dhe i plotëson kushtet e kualifikimit për në Holiday Rally, atëherë në Holiday Rally nuk mund të marrësh shërbim VIP, por natyrisht kualifikohesh në nivelin 1.

*Ai që në periudhën e parë ose të dytë të kualifikimit kapërcen dy ose më shumë nivele në sistemin tonë Marketing merr shërbimin VIP në Holiday Rally, pra arrin nivelin 2.*

**Strehim:** në hotele me 5 yje me shërbim all inclusive.

Punonjësit e kualifikuar në nivelin 2 i transportojmë me autobusa VIP në vendin e organizimit të Rally-t, gjatë aktivitetit marrin shërbim VIP në bufe, për ta krijujmë pika shitjesh VIP dhe për ta s'ka qëndrim në radhë.

Punonjësit e kualifikuar në nivelin 1 duhet ta paguajnë vetë udhëtimin, dhe natyrisht me pagesë mund t'i marrin në përdorim shërbimet e firmës sonë.

#### **Kur dhe ku do të organizohet Holiday Rally I?**

Në 24, 25, 26, 27 qeshor 2010 në Poreç të Kroacisë.

#### **HOLIDAY RALLY II – KAPËRCE NJË NIVEL!**

##### **Periudha e kualifikimit:**

nga 1 qershor 2010 deri më 31 gusht 2010.

**Kush mund të kualifikohet?** Çdo distributor i ri dhe i vjetër, i cili në planin Marketing ngjitet në një nivel më të lartë se sa niveli aktual (nga niveli i Distributorit mund të kualifikohesh vetëm me arritjen e nivelit të Supervizorit).

#### **Mund të marrin pjesë edhe të risponsorizuarit!**

#### **Cilat janë kushtet e kualifikimit të këtij programi motivues?**

Kushtet e kualifikimit për në Holiday Rally II janë të njëjta me ato të Holiday Rally I.

#### **Kur dhe ku do të organizohet Holiday Rally I?**

Në 30 shtator, në 1, 2, 3 tetor 2010 në Poreç të Kroacisë.

Ju presim dhe ju ripresim në Poreç!

**Tibor Radoczki**  
soaring menaxher





*- aty ku takohet profesioni -*

# ERDHI PËRSËRI DITA E RRJETNDËRTUESVE!

**Vjet në prill u organizua për herë të parë në Hungari takimi Klasikët e MLM-s, forumi ku ata që merren me MLM mund të mësojnë nga njëri tjetri rreth ndërtimit profesionist të rrjetit dhe mund të hedhin bazat e suksesit të biznesit të tyre. Sivjet më 17 prill në Arenën Sportive Papp Laszlo të Budapestit organizohet përsëri Dita e Rrjetndërtuesve, ku në skenë shfaqen gjashtë nga më të suksesshmit. Endërruesi dhe krijuesi i aktivitetit është Emil Tonk të cilin e pyetëm se si u prit takimi i parë i madh, si dhe rreth planeve të sivjetshme.**

## **Si dhe kur të lindi idea e Klasikëve të MLM-s?**

Ishte një nga ëndrrat e mia të vjetra që të organizoja një takim të vendasve të merren me MLM, të pavarur nga firmat, në mënyrë që të mësojnë nga njëri tjetri. Mendoj se këtë zanat ia vlen ta ushtrosh vetëm në mënyrë profesioniste, gjë e cila pa përvetësimin e njohurive profesionale nuk funksionon.

**Ditën e parë të Rrjetndërtuesve** e organizuam vjet në prill. Kjo ditë u prit me shumë dyshime, por u treguam këmbëngulës që me të vërtetë nevojitet një aktivitet i tillë që përforcon bashkimin profesional të rrjetndërtuesve.

## **A je i kënaqur me pritjen e takimit të parë të Klasikëve të MLM-s?**

Ashtu siç pritej aktiviteti u vlerësua mirë nga gjithë pjesëmarrësit. Morrën pjesë më shumë se 2500 mysafirë nga Hungaria dhe vendet fqinj,







të cilët ishin pjesëtarë të eksperiencës ku rrjete dhe drejtues që janë konkurent në ndërtimin e rrjetit shkëmbyen me njëri tjetrin njohuritë dhe përvojat e tyre në lidhje me profesionin Network Marketing. Morrëm shumë reagime pozitive të cilat vërtetojnë se përpjekjet nuk ishin të kota.

### **Cili është qëllimi yt në të ardhmen me Klasikët e MLM-s? Me sa e dimë po organizohet aktiviteti i ardhshëm.**

Reagimet pozitive na nxitën që ta përsërisim aktivitetin me pjesëmarrës të rinj. Shumë rrjete dhe rrjetndërtues po përgatiten për në takim, jam i bindur që ajo do të jetë një ditë e jashtëzakonshme e profesionit MLM. Në 17 prill 2010 – ashtu si vitin e kaluar – presim përsëri jashtë lektorë të cilët ashtu si ata që u shfaqën vjet kanë arritur suksese të mëdha në ndërtimin e rrjetit. Qëllimi është përsëri prezantimi i vlerave dhe përparësive të profesionit, si dhe përforcimi i vlerësimit dhe prestigjit të ndërtimit të rrjetit. Jam i sigurt që ky takim i dytë do të ngall interes akoma më të madh.

### **Cilët do të jenë lektorët nga FLP-ja?**

Jam krenar që do të marrin pjesë dy persona të shkëlqyer të rrjetit FLP: Diamant-Safir menaxheri **Robert Varga** dhe Safir menaxheri **Istvan Halmi**. S'kam dyshim që ashtu si **Miklos Berkics** edhe ata do t'i dhurojnë një leksion të shkëlqyer pjesëmarrësve të aktivitetit. Për mua është plotësisht e natyrshme që edhe lektorët e tjerë mysafir do të prezantojnë njohuritë e tyre më të mira. Ky është një rast i rrallë kur mund të dëgjojmë për anët dhe vlerat pozitive të profesionit, dhe mund të takohemi me ndërtuesit e rrjeteve të tjera.

### **Rreth çfarë temash do të bëhet fjalë sivjet?**

Në aktivitetin e tanishëm do të theksojmë rëndësinë e mësimit, dhënies së shembullit personal dhe bërjes drejtues. Do të bëhet fjalë edhe rreth forcës së bashkëpunimit dhe ndërtimit.

### **Çfarë ia vlen të dish me çdo kusht rreth takimit?**

Është diçka e madhe që brenda një dite në një ambient të vetëm mund të takohesh me drejtues të shkëlqyer dhe rrjetndërtues që duan të mësojnë. Të krijojmë dhe përforcojmë prestigjin e profesionit, ta marrin vesh të gjithë që ndërtimi i rrjetit është një mundësi e shkëlqyer e zhvillimit të personalitetit!

### **Çfarë mesazhi u jep lexuesve?**

I pres të gjithë me kënaqësi në **17 mars 2010**, takohemi në Arenën Sportive Papp Laszlo të Budapestit! Ju premtoj që do të jetë një eksperiencë e rrallë. Ju rekomandoj të gjithëve që këtë ditë ta shënoni në kalendar si dita e shkollës private MLM dhe të gjithë të kenë si moto: „Njeriu i zgjuar mëson nga përvojat personale, kurse nga përvojat e të tjerëve bën karrierë”.

*Rreth aktivitetit mund të merrni vazhdimisht informacion në faqen e internetit [www.mlmlklasszikusok.hu](http://www.mlmlklasszikusok.hu) dhe në numrin e telefonit +36-20-497-13-9. Në këtë faqe ekziston edhe mundësia e porositjes online, si dhe informacion rreth blerjes së biletave në grup.*



# CONQUISTADOR

2009

## CLUB



1. LIPP SZILVIA  
DHE MOLNÁR MIHÁLY



5. MÁTÉ KISS IMRE



2. VARGA JÓZSEFNÉ



6. WEHLINÉ MEZEI ARANKA  
DHE WEHLI PÉTER



3. MULADI ANNAMÁRIA



7. VANYÁNÉ DÁNFFY BEÁTA  
DHE VANYA LÁSZLÓ



4. BALOGH TÜNDE



8. ZLATKO JUROVIĆ  
DHE SONJA JUROVIĆ

### FOREVER

IMRPRESSUM

**Botues:** Forever Living Products Hungari Shpk.

**Redaksia:** FLP Hungari Shpk. 1067 Budapest, Szondi u. 34. Telefon: (36-1) 269-5373 Fax: (36-1) 312-8455

**Kryeredaktor:** Dr. Sandor Milesz Redaktor: Attila Földi, dr. Csaba Gothárd, Valeria Kismarton, Zsuzsanna Petroczy, Kalman Posa, Sandor Rokas,

**Layout, përgatitje për shtypje:** Crossroad Consulting Shpk.

**Koordinator projekti:** Szilvia Timar Redaktor leximi: Zita Kempf Korrigjues: Ildiko Kiraly **Redaktor projekti:** Raden Hannawati

**Fotograf:** Robert Laszlo Bacsi, Dimitrije Ostojic, Gábor Puskás, „Tomic”

**Përkthim, redaktim:** Dr. Marsel Nallbani (shqip), Darinka Aničić, Žarko Anić Antić (kroat), Otilia Toth-Kasa, Balazs Molnar, Dragana Meseldžija (serb), Jolanda Novak Csaszar, Biro 2000 Ljubljana (sloven).

**Shtypshkronja:** Palatia Nyomda és Kiadó Shpk. U përgatit në 39180 kopje.

Për përmbytjen e artikujve përgjegjësia është e autorëve. Çdo e drejtë mbrohet!

[www.flpseeu.com](http://www.flpseeu.com)

# FOREVER BUSINESS ACADEMY



## AKADEMIA E BIZNESIT FOREVER TË SPONSORIZON TY

**N**isi Akademia e Biznesit Forever. Dhe jo me hapa të vegjël! Që në dy muajt e parë erdhën më shumë se dyqind punonjës në trainime. Ishte një kënaqësi e veçantë për mua që disa njerëz më morrën edhe në telefon që t'i ndihmoj në zgjidhjen e problemeve të tyre të përditshme komunikative, herë biznesi, herë personale. Është kënaqësi sepse kjo do të thotë që ato që mësojmë fillojnë të hedhin rrënjë edhe në ditët tona të zakonshme. Një analizë e jona – jo reprezentative – tregon se shumica e punonjësve e konsideron të nevojshme, është dakort me krijimin e Akademisë, dhe i mbështet qëllimet e saj. Ky është një mesazh shumë i rëndësishëm – dhe kryesisht nxitës dhe motivues – për të gjithë ne. Çfarë mund të shkruaj tjetër – si person që merret me kuaj – përveç lavdërimit të „kalit” tim? Në mënyrë që të shmag mungesën e besueshmërisë më poshtë ua jap fjalën dëgjuesve të cilët ishin aty dhe nuk kursyen kohë dhe energji që të mbajnë shënim opinionin e tyre.

*„Mësova shumë. U dëgjua informacione të shumta në aspekte të reja në krahasim me trainimet e deritanishme (dhe unë kam lexuar shumë libra). Morra me vete njohuri të larmishme, të qarta dhe që mund të përdoren mirë në praktikë. Këtij trainimi i duhet bërë një reklamë më e madhe!”*  
**Dr. Maria Debródi, senior menaxhere**

*„Ishte një trainim i suksesshëm në çdo aspekt. Morrën njohuri të kuptueshme rreth fushave në të cilat deritani nuk ishte gjithçka e qartë. Morrëm në mënyrë të pastër dhe të qartë gjithçka që duhet t'i ofrojmë Tjetrit në interes të biznesit tonë të suksesshëm. Procedura e trainimit ishte shumë profesioniste dhe plotësisht e qartë.”*  
**Miklos Mester, menaxher**

*„Dëgjuam gjithçka në fjali të shkurtra dhe të qarta. Mendoj se më e rëndësishme në një leksion është të jetë i kuptueshëm. Është një punë shumë serioze, jepet shembull për gjithçka! Mua më ndihmon të zgjidh problemet e mia në praktikë.”*  
**Zoltan Richard Toth, asistent menaxher**

*„U sqaruan në pikëpamje të reja çështje të njohura deritani, dhe morra udhëzime me vlerë rreth mënyrës së shfrytëzimit të njohurive të mia për një punë më rezultative. Ishte një ditë shumë me vlerë për mua. Do të vij përsëri!”*  
**Julika Togyerne**

Opinionet janë me vlerë edhe për mua personalisht. Ato tregojnë që së bashku po ecim në drejtimin e duhur në rrugën e diturisë. E jani pra sa më shumë dhe ta zgjerojmë mëtej këtë rrugë!



KONTAKTIM:

**QENDRA MËSIMORE E RRUGËS SZONDI**

1067 BUDAPEST, SZONDI U. 34.

+36 1 332 5956

DREJTORI I ZYRËS: ADAM PACZOLAY

**AKADEMIA TREGËTARE FOREVER**

PROJEKTUES: DR. CSABA GOTHARD

+36-20-207-1211

PËR TË MARRË NJOFTIME RRETH PROGRAMIT TË AKADEMISË TREGËTARE FOREVER MUND TË  
REGJISTROHENI ME LETRËN E DËRGUAR NË ADRESËN E-MAIL TË MËPOSHTME: SZONDI@FLPSEU.HU

# Produktet e zgjoit të bletës



## Forever Royal Jelly®

Royal Jelly është një sekrecion si qumësht që del nga gjendrat e fytit të bletëve. Me këtë ushim të shkëlqyer që është i përzier me enzima ushqejnë çdo bletë që e konsiderojnë si mbretëreshë. Ky është ushqimi special i bletës mbretëreshë gjatë gjithë jetës së saj, me ndihmën e të cilit ajo është e aftë të nxjerrë 3000 vezë në ditë gjatë jetës së saj gjashtë vjeçare. Bletët punëtore që hanë mjalt të zakonshëm jetojnë vetëm 4-6 javë.

Royal Jelly përmban vitamin A, C, D, dhe E, si dhe është përmbajtës natyror i pasur i shkallës komplekse të vitaminave B. Përbërësja kryesore është vitamina B5 (acidi pantotenic). Royal Jelly përmban në sasinë e nevojshme të tetë aminoacidet esenciale, dhjetë aminoacide dytësore, si dhe lëndë minerale – si kalcium, bakër, hekur, fosfor, kalium, silicium dhe squfur. Në Royal Jelly gjendet edhe acid nukleinik.

Është i pasur në proteina. Prodohet gjatë tretjes së pjalmnit. Royal Jelly ynë është i thatë, mblidhet

në zona të shkreta larg shiut. Zgjoin tonë e kemi vendosur në këtë mjedis të shkëlqyer e të pastër natyror. Royal Jelly-n e liofilizojnë menjëherë pas nxjerrjes nga zgjoit, në mënyrë që nga produkti të largohet vetëm uji, duke ruajtur kështu gjithë vitaminat, lëndët minerale, enzimat dhe koenzimat.

### PËRBËRËSIT

Ëmbëlsues (sorbit), fruktoz, pjalm rojal, acid citrik, aromë, lëndë ndriçuese (acid stearik), lëndë që pengojnë mpiksjen (stearat magnezi), dioksid silici.

60 tableta

### MËNYRA E PËRDORIMIT

2x1 tabletë. Konsumimi i produktit nuk u rekomandohet atyre që vuajnë nga astma, apo janë alergjik ndaj mjaltit dhe polenit.



- Një nga ushqimet më komplekse
- Thithet lehtë dhe tretet në mënyrë të përsosur

PRODUCT #036